



KONTROLLI I LARTE I SHTETIT K R Y E T A R I

Nr. 572/12 Prot.

Tiranë, më 23/09/2016

V E N D I M

**Nr. 101, Datë 08/09/2016
Revokuar me vendimin nr. 113, datë 23.9.2016**

PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË KËSHILLIN E QARKUT TIRANË "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe mendimin e Drejtorit të Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare", të ushtruar në Këshillin e Qarkut Tiranë, për periudhën nga data 01.10.2013 deri më datë 30.05.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 275/8, datë 23.02.2010 të Kontrollit të Lartë të Shtetit është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit, ku janë rekomanduar 9 masa organizative dhe 7 masa shpërblim dëmi në masën 526,286 lekë.

Nga 9 masa organizative nuk janë zbatuar 4 masa, ndërsa nga 7 masa shpërblim dëmi me vlerë 526,286 lekë nuk janë zbatuar 4 masa me **vlerë 371,314 lekë**.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Këshillit të Qarkut Tiranë, të marrë në analizë situatën e zbatimit të urdhrit nr. 14, datë 11.03.2010 “Për zbatimin e masave të rekomanduara me shkresën nr. 275/8, datë 23.02.2010 të KLSH^{së}”, të dalin përgjegjësitë individuale për mos vlerësim dhe zbatim të masave të rekomanduara nga KLSH, si dhe të hartohet plan-veprimi specifik për vlerësimin sipas afateve administrative.

Brenda muajt Tetor 2016

2. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar plotësisht kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Konkretisht, nuk janë miratuar gjurmët e auditimit, nuk janë identifikuar zonat me risk dhe rrjedhimisht nuk është përpiluar strategjia për menaxhimin e tij, nuk është hapur regjistri i riskut ku të regjistrohen raportimet dhe masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsisive, veprime në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Këshilli i Qarkut Tiranë ka funksionuar me një Rregullore të Brendshme e cila nuk përshtatet me strukturën e re organizative të miratuar.

2.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara të kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe të marrë masat e nevojshme për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2.2. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë të marrë masa dhe të hartojë Rregulloren e Brendshme, me përshkrimet e vendeve të punës në përputhje me organigramën e miratuar, të përgatisë dhe raportojë “Raportin Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm” dhe “PyetëSORIN e vetëvlerësimit të funksionimit të SMFK”, në mënyrë të plotë e të saktë për çdo rubrikë e komponent në përputhje me standardet në formë e përmbajtje, me synim paraqitjen e realitetit me besueshmëri.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer në ditarin e veprimeve të ndryshme të vitit 2014, rezulton se: z. L.K. është ngarkuar për vlerën 546,024 lekë për detyrim të krijuar për llogari të zyrës së përbarimit privat “XXXXXXXXXX”.

Z. L.K. duhej të ishte paraqitur debitor për vlerën 382,434 lekë më datë 31.12.2015, ndërkohë që në librin analitik të kontabilitetit nuk figuron, por është mbyllur me llogarinë 4341 apo 4342 përfitime si këshilltar.

Gjithashtu në disa llogari të pasqyrave financiare, u konstatuan shuma të mbajtura në pozicione të gabuara, si: llogaria 468 “Debitor të ndryshme” për vlerën 713,007 lekë, në vitin 2014 është hedhur në llogarinë 465 “Efekte për tu arkëtuar”. Janë kryer veprime për debitorët jashtë bilanci, si rrjedhojë nuk rakordon teprica e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, me tepricën analitike të kësaj llogarie, pavarësisht se rezultati në aktivin e pasqyrave financiare (bilanc) nuk ndryshon, veprime në kundërshtim me kreun II “Mbajtja e aktiveve dhe detyrimeve”, neni 6 “Evidenca mbështetëse”, pika 1 dhe 2, neni 7 “Inventarizimi i aktiveve dhe i detyrimeve”, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Koordinim Zhvillimit në Këshillin e Qarkut Tiranë (Zyra e financës), të sistemojë diferencën e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” të z. L.K. për vlerën **382,434 lekë**, duke saktësuar veprimin e kontabilizimit në llogarinë sintetike me llogarinë

kundërparti, duke bërë korrigjimin e rezultatit në pasqyrat financiare (bilanc) për vitin 2015 dhe me shkresë përcjellëse të bëhet njoftimi i zyrës përmbarimore “ ”, si dhe të marrë masa në lidhje me sistemimin dhe pasqyrimin padrejtësisht në llogarinë 465 “Efekte për t’u paguar”, të shumës **713,007 lekë**, e cila duhej pasqyruar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, sipas kërkesave ligjore.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2016

4. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Tiranë ka aplikuar normativa të larta të konsumit të karburantit për dy automjetet të amortizuara (TR3186I dhe TR7195G), si dhe nuk ka testuar mjetin e blerë në muajin gusht të vitit 2013, tip “Nisan” me targë AA011 HD në lidhje me përcaktimin e normës së harxhimit të karburanti për 100 km.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Koordinim Zhvillimit në Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa duke ngritur grup pune me specialistët të fushës dhe të llogarisë normën harxhimit të karburantit, për mjetin tip “Nisan” me targë AA011HD.

Brenda muajt Tetor 2016

5. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Qarkut Tiranë ka përballuar gjithsej shumën 1,729,692 lekë, shpenzime gjyqësore dhe paga për punonjësit e larguar nga punë para vitit 2013. Theksojmë se Këshilli i Qarkut nuk ka analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë ndaj shkaktarëve, veprim në kundërshtim me UMF nr. 2, datë 18.08.2011 dhe nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, si dhe pikën 62 dhe 102, të UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”. Këshilli i Qarkut paraqet me detyrime një vendim gjyqësor që i ka kaluar të gjitha shkallët e gjyqësorit deri në Gjykatën e Lartë me nr. 00-2012-376, datë 06.09.2012, të fituar nga ish-punonjësja znj. Zh.H. për largime nga puna, ç’ka ka shkaktuar pagesë të dyfishtë për të njëjtin vend pune dhe ka dhënë ndikim negativ në buxhetin e Këshillit Qarkut Tiranë për vlerën e likuiduar në shumën 645,783 lekë, për të cilën nuk ka dalë përgjegjësia ndaj personave.

5.1 Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë individuale për largimin nga puna të punonjësve, duke bërë që për të njëjtin vend pune të kryhen shpenzime dyfishta, me një efekt negativ në buxhetin e Këshillit Qarkut për vlerën **1,729,692 lekë**.

Brenda muajt Tetor 2016

6. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave (DAMT^{ja}), në asnjë rast të dëmtimit të tokës nuk ka mbajtur akt administrativ për penalizimin e personit përgjegjës në referencë të nenit 14, të ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës” dhe pikës 24, të VKM nr. 532, datë 31.10.2010 “Për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga SAMT në Qarqe dhe ZMMT në komune dhe/ose bashki”, për dëmtimet e tokës bujqësore nga ndërtimet pa leje, të përcaktuara në ligjin nr. 7679, datë 07.04.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

Mungesa e kontroleve mbi zbatimin e projekteve për shfrytëzimin e resurseve nga shoqëritë private dhe mos marrja e masave administrative për këtë qëllim, janë në kundërshtim VKM nr. 532, datë 31.10.2002 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga Seksionet e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark dhe Zyrat e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së tokës në Komunë ose Bashki”, i ndryshuar, pika 26.

Mungesa e një studimi të mirëfilltë të zonave për krijimin dhe zgjerimin e sipërfaqeve urbane në zonat rurale, në bashkëpunim me Zyrën e Planifikim Territorit të njësive vendore, veprime në kundërshtim me pikën 27, të VKM nr. 532, datë 31.10.2002 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga seksionet e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qark dhe zyrat e menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës në komune dhe/ose bashki”.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) në bashkëpunim me Zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZAMT) të Njësive Vendore, për çdo rast të dëmtimit të tokës bujqësore, të marrë masa për parandalimin e dëmtimit të saj dhe vënien para përgjegjësive të personave përgjegjës.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të paraqitur mbi aktivitetin e Inspektoratit të Mbrojtjes Tokës (IMT), u konstatua se:

Inspektorati i Mbrojtjes Tokës (IMT) në Këshillin e Qarkut Tiranë, nuk ka kërkuar nga Zyra e Administrimit të Mbrojtjes Tokave (ZAMT) në komuna/bashkia, plotësimin e formularëve (6 evidenca), në të cilat janë parashikuar të gjithë faktorët e mundshëm që cenojnë dëmtimin e tokës bujqësore, formularë të cilat në mënyrë periodike çdo 6/muaj i janë përcjellë IMT në Këshillin e Qarkut Tiranë. Këto të dhëna pasqyrohen në regjistrin e mbrojtjes së tokës, dhe mbi bazën e tyre është organizuar puna për evidentimi në terren të këtyre faktorëve.

Mungesa e bashkëpunimit me Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor, mbi depozitimin e evidencave brenda muajt Janar të vitit pasardhës, mbi evidencën e gjendjes dhe të ndryshimeve vjetore të kategorisë së resurseve, në administrim shtetëror, komunal dhe privat, si pyje, tokë pyjore, kullota, livadhe dhe të tjera, objekt i veprimit të ligjeve nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” dhe nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për fondin kullor”, në zbatim të nenit 13, të ligjit nr. 10257, datë 25.03.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”.

Mungesa në strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Tiranë, të IMT^{së}, sipas Vendimit të Këshillit të Qarkut Tiranë nr. 14, datë 12.02.20016, është në kundërshtim me ligjin nr. 9244, datë 17.05.2004 “Për mbrojtjen e Tokës” dhe VKM nr. 80, datë 28.01.2005 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore”.

7.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Financave, të marrë masa për krijimin e strukturës së IMT me specialistë të fushës, duke kërkuar revokimin e nenin 15, të ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015 “Për buxhetin e Viti 2016” dhe në rast të kundërt brenda strukturës së miratuar të shikohet mundësia e krijimit të strukturës së IMT, si sektor kryesor në marrjen e masave për parandalimin e dëmtimit të tokës bujqësore nga faktorë të ndryshëm.

Brenda muajt Tetor 2016

8. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit të veprimtarisë së IMT, u konstatua se në 4 raste procesverbalet e konstatimit nuk janë kthyer në vendim me gjobë në masën 500,000 lekë (secili), dhe nuk është kërkuar ndjekje penale, ndaj dëmtuesve të tokës bujqësore A.S. subjektet shkaktar “[REDACTED]”, pronarit të tokës bujqësore “Q.D.”, zaptuesit të tokës “T.K.” dhe subjektit shkaktar “L.K.”, veprim këto në kundërshtim me Kreun V, nenet 18, 27, 28, 29 dhe 31, të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Këshillit të Qarkut Tiranë në mbledhjen e radhës së Komisionit të Mbrojtjes së Tokës (KMT) në qark dhe në mungesë të IMT, të analizojë të gjitha rastet e dëmtimit të tokës bujqësore të evidentuara me procesverbal konstatimi nga IMT-ja dhe për rastet kur nuk është marrë asnjë masë për kthimin e tokës bujqësore në gjendjen fillestare, të aplikohet penaliteti në masën **500,000 lekë** dhe të kërkohej ndjekje penale ndaj dëmtuesve të tokës bujqësore, *respektivisht:*

-Subjekti “A.S.” pronar i tokës bujqësore dhe subjekti “[REDACTED]”, si personi që ka dëmtuar tokës bujqësore.

-Subjekti “Q.D.” pronar i tokës bujqësore.

-Subjekti “**T.K.**” zaptuesi i tokës bujqësore dhe subjektit “**L.K.**”, si personi që ka dëmtuar tokës bujqësore.

Brenda muajt Tetor 2016

9. Gjetje nga auditimi: Inspektoratit të Mbrojtjes Tokës në Këshillin e Qarkut Tiranë, ka ndjekur nga afër veprimtarinë e dëmtimit të tokës nga sipërmarrësi i punimeve “**[REDAKTUAR]**”, për ndërtimin e rrugës Tiranë - Elbasan, e cila shtrihet përgjatë këtij segmenti në fshatin Mushqeta ZK 2752. Ky dëmtim ka vijuar që nga viti 2012.

Inspektoratit të Mbrojtjes Tokës (IMT) nga ana e sajë ka mbajtur 15 (pesëmbëdhjetë) akt-konstatime të dëmtimit të këtyre sipërfaqeve tokë bujqësore. Sipas matjeve në terren me përfaqësues ish-Komuna Kërrabë është evidentua një sipërfaqe e dëmtuar e tokës bujqësore prej 17935 m².

Me shkresën nr. 2444, datë 27.09.2012 të KQ Tiranë, është njoftuar subjekti “**[REDAKTUAR]**” për fillimin e procedurave (vendosje sanksionesh), mbi dëmtimet e tokës bujqësore në zbatim të dispozitave të neneve 16, 18 dhe 21, të ligjin nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e Tokës bujqësore”.

Me shkresën nr. 2215, datë 25.09.2012 të KQ Tiranë, është njoftuar ish-Kryetari i Komunës Kërrabë, mbi procedurat e ndjekura nga IMT^{ja}, duke u kërkuar zbatimin e kompetencave ligjore për nxjerrjen e akteve për mbrojtjen e tokës bujqësore, sipas dispozitave të nenit 10, pika 1 dhe 2, të ligjin nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e Tokës bujqësore”, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës; S.A. dhe Sh.A. M.L. S.L. të cilët kanë lidhur akt-marrëveshje me subjektin “**[REDAKTUAR]**” për depozitim inerte, veprime në kundërshtim me nenit 17, të ligjin nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e Tokës bujqësore”.

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Këshillit të Qarkut Tiranë në mbledhjen e radhës së Komisionit të Mbrojtjes së Tokës (KMT), të analizojë rastet e dëmtimit të tokës bujqësore të evidentuara me akt-konstatim nga IMT^{ja} dhe për rastet kur nuk është marrë asnjë masë për kthimin e tokës bujqësore në gjendjen fillestare, të aplikohet penalteti në masën 500,000 lekë dhe të kërkohet ndjekje penale ndaj dëmtuesve të tokës bujqësore (*sipas pasqyrës aneks 19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Brenda muajt Tetor 2016

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa V, kreu I “Akti administrativ”, nenet 98-102, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 21-33 “Funksionimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore”; ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 608-628 në vijim, dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 737,385 lekë, si më poshtë:**

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2014 janë shpërblyer **4 punonjës** të administratës së Këshillit të Qarkut Tiranë në vlerën **227,341 lekë**, për “Rezultate të mira në punë, gatishmëri në kryerjen e detyrave brenda dhe jashtë orarit të punës, kryerjen me intensitet dhe korrektësi të tyre”, në kundërshtim me pikën 1, të VKM nr. 905, datë 17.12.2014 “Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar dhe urdhrin nr. 58, datë 29.12.2014.

1.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **227,341 lekë**, nga punonjësit dhe ish-punonjësit: **znj. M.K.** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore në vlerën **61,632 lekë**, **znj. E.D.** me detyrë specialiste finance në Drejtorinë e Koordinim Zhvillimit në vlerën **71,793 lekë**, **znj. E.L.** me detyrë ish-specialiste për politikë sociale në vlerën **45,458 lekë** dhe **znj. E.P.** me detyrë ish-specialiste për arsimin dhe shëndetësinë në vlerën **48,458 lekë**.

Brenda muajt Tetor 2016

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumenteve të bankës për vitin 2014, u konstatua se është paguar “Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare” në vlerën 41,256 lekë, me objekt shpenzimi shërbim koktej pritje përcjellje. Qëllimi i përdorimit të këtij shpenzimi është “*Aktivi i Partisë së Qarkut Tiranës*”. Bazuar në dokumentet bashkëlidhur, likuidimi i vlerës prej **41,256 lekë** është në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 4, si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të sektorit publik”, pikat 35 dhe 36.

2.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **41,256 lekë**, nga punonjësja **znj. E.D.** me detyrë specialiste finance në Drejtorinë e Koordinimit Zhvillim, në cilësinë e ish-Drejtorit Ekonomik për likuidimin e mallit pa dokument.

Brenda muajt Tetor 2016

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të përdorimit të karburantit nga mjetit tip “Nisan” me targë AA011HD, i Këshillit të Qarku Tiranë, rezultoi se:

a. Drejtuesi i mjetit z. K.T. për periudhën Janar-Shtator 2015, është furnizuar me 3200 litra naftë, ku sipas dokumentacionit janë përshkruar 30,054 km. Bazuar në normativën e vetë mjetit (dokumentet e tenderit 9.3 litra/100 km), mjeti duhet të kishte realizuar 34,409 km, pra realizuar më pak 4,355 km, duke mos justifikuar harxhimin e 404 litrave karburant për vlerën **73,851 lekë**.

b. Drejtuesi i mjetit me targë AA011HD, z. B.M. për periudhën Tetor-Dhjetor 2015, është furnizuar me 1,070 litra naftë, ku sipas dokumentacionit janë përshkruar 10,784 km. Bazuar në normativën e vetë mjetit (dokumentet e tenderit 9.3 litra/100 km), mjeti duhet të kishte realizuar 11,504 km, pra realizuar më pak 720 km, duke mos justifikuar harxhimin e 67 litrave karburant për vlerën **12,187 lekë**.

Nga rakordimi për periudhën e pesë mujorin e parë të vitit 2016, për km e përshkuara (20,342 km) - furnizimet (200) - normativat e karburantit (9.3/100), rezulton diferenca e pa justifikuar për 108 litra karburant me vlerën **17,402 lekë**, veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **103,440 lekë**, nga ish-punonjësit: **z. K.T.** me detyrë ish-drejtues mjeti në vlerën **73,851 lekë**, **z. B.M.** me detyrë punonjës mbështetës i transportit dhe logjistikës në vlerën **29,589 lekë**.

Brenda muajt Tetor 2016

4. Gjendje nga auditimi: Në auditimin e pasqyrave financiare (bilanci) për vitin 2013 e në vazhdim, në lidhje me tepricën e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 31.12.2015, u konstatua një diferencë për vlerën **166,314 lekë**, e cila lidhet me ditarin e veprimeve të ndryshme të muajt dhjetor 2013, ku rezulton të jenë rënduar (debituar) shpenzimet operative të institucionit (llog. 602), duke çliruar padrejtësisht subjektet: “B.S.” në vlerën 35,914 lekë, “Zenit-06” për vlerën 48,800 lekë, “XXXXXXXXXX” për vlerën 81,600 lekë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin” dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për

menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Në lidhje me këtë veprim, u konstatua se vlera prej **166,314 lekë** ka lidhje me moszbatimin e masë për shpërblim dëmi” pika 3 e Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH vitit 2010”.

Nga shqyrtimi i veprimit të mësipërm, rezulton se detyrimet nuk janë paguar dhe kreditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk është i saktë, i parregullt dhe vlera prej **166,314 lekë** përbën shkelje financiare me dëm ekonomik dhe kërkohet të ç’dëmtohet.

4.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të analizoje dhe të kryejë rikontabilizimin e detyrimeve në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke nxjerrë përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës, si dhe të arkëtojë vlerën **166,314 lekë**, respektivisht: subjekti “**B.S.**” për vlerën **35,914 lekë**, subjekti “**Zenit -06**” në vlerën **48,480 lekë** dhe subjekti “**[REDAKTUAR]**” për vlerën **81,600 lekë**, si dhe të bëjë korigjimin e rezultatin financiar të vitit 2015, për të njëjtën vlerë.

Brenda muajt Tetor 2016

5. Gjetje nga auditimi: Në Këshillin e Qarkut Tiranë për periudhën 2014 - 2015, nuk janë zbatuar kushtet e kontratës së lidhur me subjektin “**[REDAKTUAR]**” sh.p.k, pasi janë likuiduar mallra (kafe dhe ujë), mbi fondin limit të miratuar në vlerën **138,934 lekë**, nga e cila; në vitin 2014 për vlerën 31,434 lekë dhe për vitin 2015 në vlerën 107,500 lekë, veprime në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik.

5.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **138,934 lekë**, nga punonjësja **znj. E.D.** me detyrë specialiste finance në Drejtorinë e Koordinimit Zhvillim, në cilësinë e ish-Drejtorit Ekonomik për likuidimin e mallit pa dokument.

Brenda muajt Tetor 2016

6. Gjetje nga auditimi: Në Këshillin e Qarkut Tiranë në një rast për vitin 2015, janë kryer shpenzime në vlerën 60,100 lekë, me objekt “*Riparim pajisjeve të zyrave (kompjuter e fotokopje)*”, me procesverbal të rasteve të emergjencës, në kushtet edhe kur janë marrë tre oferta të cilat janë pa datë. Në procesverbalin e emergjencës ka identifikim vetëm për 1 (një) fotokopje, pa identifikuar tipin e saj dhe pa procesverbal konstatim defektesh. Sipas faturës së paraqitur, rezulton se janë riparuar 2 fotokopje nga një që ka procesverbali i emergjencës, si dhe janë kryer riparime e formatime për 2 furra e kokë printeri dhe për 2 formatim kompjuteri, ndërrim HDD e antivirus (jashtë këtij procesverbali), duke mos përcaktuar se çfarë marke janë kompjuterët, kujt i takojnë dhe procesverbal konstatim defektesh, veprime në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në vlerën **60,100 lekë**, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” neni 40, me Udhëzimin e APP nr. 02, datë 28.03.2013 dhe nr. 03, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, me Urdhrin MF nr. 33, datë 11.07.2013 dhe nr. 57, datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela 1/3, nenin 13, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 37, 42, 43 dhe 44.

6.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **60,100 lekë**, ndaj punonjësve dhe ish-punonjësve: **znj. E.M.** me detyrë ish-specialist finance, në cilësinë e kryetarit të KBVV për vlerën **20,034 lekë**, **znj. G.N.** me detyrë ish-specialist për emergjencat civile, në cilësinë e anëtarit të KBVV për vlerën **20,033 lekë** dhe **znj. E.S.** me detyrë ish-specialiste për bujqësorë, në cilësinë e anëtarit të KBVV për vlerën **20,033 lekë**.

Brenda muajt Tetor 2016

B/1. MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit në ish- Ndërmarrjen e Rrugëve Rurale të Qarkut Tiranë në tenderin me objekt “*Blerje karburant (naftë) për vitet 2014-2015*”, me fond limit 3,000,000 lekë, nga e cila; viti 2014 në me fond 1,500,000 lekë dhe viti 2015 me fond 1,500,000 lekë, ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efencë dhe ekonomikitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, si dhe përdorimin me diferencë negative në fondet buxhetore në vlerën totale **2,998,016 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 2-Parimet e përzgjedhjes, Kreu I-Dispozita të përgjithshme, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 2 e kreut V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 27 “Kontratat e mallrave”, pika 2.

1.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Tiranë, të marrë masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efencë të fondeve publike, për procedurën e prokurimit me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **2,998,016 lekë**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

Brenda muajt Tetor 2016

C. MASA DISIPLINORE:

Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” germa (c), të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe germat (g dhe k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandoj Kryetarit të Këshillit të Qarkut Tiranë që t’i kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore,

-“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58 pika “c”.

1. Znj. E.D. me detyrë ish-Drejtoresh Ekonomike, aktualisht në pozicionin specialist finance në Drejtorinë e Koordinimit Zhvillim.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mos zbatimi i rekomandimeve të KLSH^{së}, si një organ i pavarur dhe që vlerëson në mënyrë të paanshme dhe profesionale aktivitetin ekonomik e financiarë të këtij institucioni për shpërblimin e dëmit në vlerën **371,314 lekë**, sipas dispozitave të pjesën VI e kreut I të neneve 105-109, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe pika 93 e Kapitullit IV, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të cilat kanë sjellë moszbatim të neneve 15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2015, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. (Trajtuar në procesverbalin nr. 1, datë 01.07.2016 dhe faqen 15-17, të Raport Auditimit).

-Parregullsi dhe shkeljet të konstatuara në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, i ndryshuar.

-Kryerjen e pagesa për pritje përcjellje në adresë të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare me objekt “Aktiv i Partisë Socialiste të Qarkut Tiranë (aktiv politik)”, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 41,256 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9228, atë 29.04.2004, ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4, si dhe udhëzimin nr 30, datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e aktiveve të sektorit publik” pikat 35 dhe 36.

-Mos zbatimin e procedurave ligjore mbi përdorimin e fondeve publike me procedurë “blerje me vlera të vogla”, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 423,489 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1 datë 10.01.2007, “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël”, pika 6, Udhëzimin e APP nr. 02, datë 28.03.2013 dhe nr. 03, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, me Urdhrin MF nr. 33, datë 11.07.2013 dhe nr. 57, datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela 1/3 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 37, 42, 43 dhe 44.

-“Vërejtje”, neni 58 germa “a”.

1. Znj. B.G. me detyrë Drejtor e Koordinimit Zhvillim (në cilësinë kryetares së KBVV).

Për shkeljet e mëposhtme:

Mos zbatimin në 2 raste të procedurave ligjore mbi përdorimin e fondeve publike me procedurë “blerje me vlera të vogla”, mbi shpenzimet e kryera për Konferencën me temë: “Zhvillimi i Agroturizimit: Mjetet për zhvillimin Social-Ekonomik të Rajonave Tona”, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël”, pika 6, Udhëzimin e APP nr. 02, datë 28.03.2013 dhe nr. 03, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, me Urdhrin MF nr. 33, datë 11.07.2013 dhe nr. 57, datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 37, 42, 43 dhe 44, pasi përzgjedhja e subjektit fitues është bërë pa zbatuar procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, por vetëm duke lidhur akt-marrëveshje me subjektin “[REDACTED]”.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike të neneve 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 53, 56, 63, etj, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësiive individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 14, datë 04.07.2016, vërejtjet dhe komentet e subjektit të audituar në pjesën e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe germat (c dhe ç) e nenit 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **5 punonjës të Këshillit të Qarkut Tiranë**, si më poshtë:

1. **Z. M.N.** me detyrë ish-p/sektori për transportin infrastrukturën dhe zhvillimin rajonal, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT në ritenderin me objekt “*Sistemim asfaltim i rrugës “Pëllumbas Kllojkë, pjesa e dytë vazhdimi nga pik 911 -1996 L=4353”*”.
2. **Znj. E.T.** me detyrë ish-specialist për prokurimet publike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT në ritenderin me objekt “*Sistemim asfaltim i rrugës “Pëllumbas Kllojkë, pjesa e dytë vazhdimi nga pik 911 -1996 L=4353”*”.
3. **Znj. G.N.** me detyrë ish-specialist jurist për çështjet ligjore dhe të administratës, në cilësinë e anëtarit të NJHDT në ritenderin me objekt “*Sistemim asfaltim i rrugës “Pëllumbas Kllojkë, pjesa e dytë vazhdimi nga pik 911 -1996 L=4353”*”.
4. **Z. A.D.** me detyrë ish-specialist për arkivin dhe kadastrën urbane, në cilësinë e anëtarit të NJHDT në ritenderin me objekt “*Sistemim asfaltim i rrugës “Pëllumbas Kllojkë, pjesa e dytë vazhdimi nga pik 911 -1996 L=4353”*”.
5. **Znj. L.T.** me detyrë ish-specialist për zhvillimin rajonal, në cilësinë e anëtarit të NJHDT në ritenderin me objekt “*Sistemim asfaltim i rrugës “Pëllumbas Kllojkë, pjesa e dytë vazhdimi nga pik 911 -1996 L=4353”*”.

Më hollësisht për procedurën sa më poshtë vijon:

-Në tenderin me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës “Pëllumbas Kllojkë, pjesa e dytë vazhdimi nga pik 911 -1996 L=4353”, zhvilluar më datë 09.03.2015 (anuluar) dhe ritenderuar pas 38 (tridhjetetë ditësh), me datë 17.04.2015, lidhur kontrata nr. 976, datë 05.05.2015 me fond limit 54,166,667 lekë dhe i fituar në herën e dytë nga OE “XXXXXXXXXX” shpk me vlerë 52,990,000 lekë pa tvsh dhe me diferencë nga fondi limit prej **1,176,667 lekë**, u konstatuan shkeljet e mëposhtme:

a- Projekt zbatimi, specifikimet teknike, raporti teknik mbajnë datën dhjetor 2008. Nuk ka urdhër të titullarit të AK për ngritjen e një grupi pune për hartimin e projekteve dhe preventivave për këtë vepër, nuk ka analizë çmimi për zërin e punës “Mbjellje bari hydroseeding” në shumën 229,126 lekë, nuk ka të dhëna për argumentim nga punonjësit që kanë hartuar projektin, preventivin dhe specifikimet teknike në lidhje me kërkesat teknike që janë bërë në një fazë të dytë pjesë e DT.

b- Në hartimin e dokumenteve të tenderit **nuk ka argumentim** në lidhje me kërkesat për: për kategoritë e licencës profesionale NP 1B, NP 4C dhe NS 18B, veprim në papajtueshmëri me nenet 8 e 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, për numrin prej **110 persona** të fuqisë punëtore, me volumet e punës dhe afatin e punimeve, nuk është kërkuar vërtetimi i punimeve të ngjashme në sektorin privat, për vendosjen e kërkesës për mjetet që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenet; 57 dhe 61. Gjithashtu janë kërkuar që të paraqiten “licensë kodi III.2A (1+2) lidhur me ndikimin në mjedis nga QKL”, për makineri fabrikë tuba betoni, fabrikë asfalti dhe për fabrikën e betoni ofertuesi e shoqëruar me dokumentin e pronësisë, lejen mjedisore, planvendosjen (distanca nga objekti që prokurohet të mos jetë më e madhe se 20 km), kërkesa në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, geramat (c, ç dhe d), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, geramat (a, b dhe c) dhe **neni 20, “Mosdiskriminimi”**. Në projektet e DST të ndodhura në faqen e app.gov.al, nuk ka fletë projekti ku të tregohet se në çfarë pjesësh është sipërfaqja prej 16866 m² që do të mbillet me bar hydroseeding.

-Në lidhje me kërkesat për kualifikim në AK janë paraqitur 5 ankimime nga ku pas shqyrtimeve janë marrë në konsideratë me përjashtim të makinerisë për mbjellje bari me hydroseeding.

Ky tender është anuluar pasi kanë marrë pjesë 2 OE, "Fusha" shpk me ofertë 44,902,250 lekë dhe "██████" shpk, me vlerë të ofertës 39,797,360 lekë, të cilët janë s'kualifikuar pasi OE "██████" shpk, nuk plotëson kriterin e përcaktuar nga AK **prej 110 punonjësish** dhe disa ndryshime zërash në preventiv ndërsa OE "██████" shpk, pasi i mungojnë disa makineri dhe disa ndryshime zërash në preventiv

-Kjo procedurë është **rihapur** me të njëjtat të dhëna (fond limit dhe projekt e preventiv), ka marrë pjesë vetëm 1 OE, i cili është shpallur fitues (subjekti "██████" shpk me vlerë fituese 52,990,000 lekë pa tvsh dhe diferencë nga fondi limit në shumën 1,176,667 lekë).

Nga auditimi rezultoi se:

a- Në rihapjen e kësaj procedure nga ana e AK përpara se të fillojë procedura e re, nuk janë analizuar shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës.

b- DT e tenderit të rihapur kanë ndryshime në kërkesa nga DT të anuluar për të cilat nuk ka argumentim në lidhje me kërkesat shtesë si dhe këto kërkesa nuk ishin në tenderin e anuluar, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa (c, ç dhe d), neni 2-Parimet e përzgjedhjes, germa (a, b dhe c) dhe neni 20-Mosdiskriminimi, si:

- për përvojën e mëparshme, është shtuar që duhet të paraqiten punime në germim në sasinë jo më pak se 12000 m³, mbjellje bari hydroseeing në skarpate jo më pak se 8000 m², punime asfaltimi 7000 m²", në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26, "Kontratat për punë publike".

- kërkesa që OE duhet të këtë stafin e tij drejtues teknik dhe të figurojë në listë-pagesa **Ing.Agronom.**

- është ulur kërkesa për numrin e fuqisë punëtore nga **110 në 100**, në një kohë që nuk ka ndryshime në volume punimesh nga tenderi i anuluar.

- është shtuar kërkesa për leje manovrimi për 10 (dhjetë) punonjës që do të përdoren për makineritë e renda, për ing.agronom dhe ing.mjedisit, ku duhet të paraqiten certifikatat e specialistit të mjedisit të lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

c- Zhvillimi i procedurës: Tenderi është hapur me procesverbalin nr. 801/1, datë 17.04.2015 dhe ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE: "██████" shpk me vlerë të ofertës 52,990,000 lekë dhe subjekti "██████" shpk, pa ofertë ekonomike (i s'kualifikuar).

d- Nga auditimi i dokumentacionit të OE "██████" shpk, rezultoi se nuk plotëson kriterin e vërtetimit të paguar të energjisë elektrike, nuk ka paraqitur punëtorë me leje manovrimi, si dhe nuk ka në stafin drejtues teknik (në license) ing agronom por e ka vetëm në listë pagesa, në këto kushte dhe ky OE nuk duhej të kualifikohej dhe procedura duhej të anulohet.

Konkluzion: Në këto procedura prokurimi në tenderin e anuluar, OE "██████" ka marrë pjesë me ofertën prej 44,902,250 lekë ndërsa OE "██████" shpk, ka marrë pjesë me ofertë 39,797,360 lekë. Në rihapjen e tenderit (pas 38 tridhjetetë ditësh), janë shtuar kërkesat e veçanta për kualifikim në mënyrë të paargumentuar në një kohë që nuk është ndryshuar projekti, preventivi dhe fondi limit. Bie në sy fakti se është ulur kërkesa për numrin e fuqisë punëtore nga 110 në 100. OE është s'kualifikuar nga tenderi i parë dhe për faktin se nuk plotësonte këtë numër, pasi kishte paraqitur 107 punonjës.

Veprimet e mësipërme janë në papajtueshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, neni 1, "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa (c, ç dhe d), neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", germa (a, b dhe c), dhe neni 20, "Mosdiskriminimi", kërkesa në dukje favorizuese për OE "██████" shpk (i cili është i vetëm në garë), duke fituar tenderin me vlerë 52,990,000 lekë ose më shumë nga ofertimi i **parë prej 8,087,750 lekë, shumë e cila përbën efekt ekonomik negativ.**

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Këshilli i Qarkut Tiranë (Sektori i Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të **ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbiqëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Menjëherë

Shënim:

Për **18 ish-punonjësit** e mëposhtëm, masa disiplinore për shkeljet të natyrës administrative të konstatuara në auditimin e kryer në Këshillin e Qarkut Tiranë dhe Ndërmarrjen e Rrugëve Rurale, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënie, ndjekje e zbatim.

1. z. S.Gj. me detyrë ish-Kryeinspektor i IMT.
2. z. H.Q. me detyrë ish-Inspektor i IMT.
3. z. A.Sh. me detyrë ish-Drejtor i Nd/Rrugëve Rurale.
4. z. I.K. me detyrë ish-Drejtor i Ndërmarrjes së Rrugëve Rurale.
5. z. M.H. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Financës në Nd/Rrugëve Rurale (në pozicionin Kryetar i BVV).
6. znj. M.B. me detyrë ish-Specialiste e Degës Teknike (në pozicionin e anëtarit të KBVV).
7. z. Sh.Xh. me detyrë ish-Përgjegjës Sektori në Nd/Rrugëve Rurale (në pozicionin e anëtarit të KBVV).
8. z. H.B. me detyrë ish-Jurist, në cilësinë e Kryetarit të NJHDT në Nd/Rrugëve Rurale.
9. znj. L.D. me detyrë specialiste e Degës Teknike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT në Nd/Rrugëve Rurale.
10. z. L.F. me detyrë shofer administrate në Nd/Rrugëve Rurale (në cilësinë e anëtarit të NJHDT).
11. znj. E.M. me detyrë ish-specialist finance në Këshillin e Qarkut Tiranë (në cilësinë e kryetarit të KBVV).
12. znj. G.N. me detyrë ish-specialist për emergjencat civile në Këshillin e Qarkut Tiranë (në cilësinë e anëtarit të KBVV).
13. znj. E.S. me detyrë ish-specialiste për bujqësorë në Këshillin e Qarkut Tiranë (në cilësinë e anëtarit të KBVV).
14. znj. E.M. me detyrë ish-Drejtor i Shërbimeve të çështjeve ligjore në Këshillin e Qarkut Tiranë.
15. znj. E.Sh. me detyrë ish-specialist teknologjie dhe informacioni, në Këshillin e Qarkut Tiranë.
16. znj. E.T. me detyrë ish-specialist për prokurimet publike, në cilësinë e anëtarit të NJHDT.
17. z. A.D. me detyrë ish-specialist për arkivin dhe kadastrën urbane, në cilësinë e anëtarit të NJHDT.
18. znj. L.T. me detyrë ish-specialist për zhvillimin rajonal, në cilësinë e anëtarit të NJHDT.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R